

Opština Tuzi

Prilijeno/Pranuar: 10. 07. 2025				
Nr. s. org.	Shenja klas.	Nr. s. rendit.	Shtet. d.	Veta
07	B35	4394/1	-	-

From: Edmond Ujkaj <edmond.ujkaj@gmail.com>
Sent: Wednesday, July 9, 2025 12:43 PM
To: Opština Tuzi
Cc: rexhep.cunmulaj@tuzi.org.me; urbanizem@tuzi.org.me
Subject: Kerkese per sqarim per vendosjen e pengesave te shpejtesise ne rrugen kryesore ne fshatin Rakiq

Te nderuar,

Ju drejtohem me ane te kesaj shkrese per te ju njoftuar zyrtarisht per vendosjen e tri pengesave te shpejtesise (ne territorin e Komunes Kadastrale te Tuzit) ne rrugen kryesore, perkatesisht rrugen numer 1 ne Rakiq. Lokaliteti i vendosjes se tyre nese shkojme prej Tuzit drejt kalimit hekurudhor qe kufizohet me komunen fqinje te Zetes, eshte si vijon:

- para hyrjes te restoranti Niagara;
- para ktheses per t'u kthyer te ndermarrja "Kovaçi";
- paralel me piken e vrojtimit te ujevara ne lumin Cem, ne Rakiq.

Nese keto objekte ne rruge jane vendosur me lejen e organeve kompetente te Komunes se Tuzit, ju lutem qe ne baze te Ligjit mbi qasjen e lire ndaj informacioneve te me percillni ne forme elektronike ato aktvendime te organit kompetent me te cilat lejohet vendosja e ketyre barrierave ne rruge.

Nese ky nuk eshte rasti, atehere ju lutem, si qytetar i ketij vendbanimi, qe urgjentisht te ndermerren masat per heqjen e ketyre barrierave ne rrugen tone, pasi na shkaktojne demtime ne automjetet tona dhe jane instaluar pa pelqimin e organeve kompetente.

Kerkoj nga organet kompetente te Komunes se Tuzit, qe se paku ne pjesen e territorit qe nuk eshte e kontestueshme per asnjeren nga palet ne proceduren e percaktimit te kufijve komunal, mos te lejohet anarkia dhe sjellja e disa individeve ne baze te interesave te tyre personale e ne dem te komunitetit si teresi!

Une jam i vetedijshem se ka individ te papergjegjshem qe drejtojne automjetet me shpejtesi te madhe, pertej kufizimeve te shpejtesise, por nuk eshte aspak e drejte qe per shkak te disa individeve te papergjegjshem dhe shkeljet e rregullave nga ana e tyre, pasojat t'i pesojne qytetaret tjere dhe komuniteti si teresi!

E permenda kete pjesen qe i takon pa ndonje dyshim territorit te Komunes se Tuzit, pasi keto pengesa jane vendosur edhe ne shume lokalitete tjera ne vendbanimin tone, qe perndryshe une e konsideroj se teresisht i takon Malesise, perkatesisht komunes se Tuzit, por aktualisht per shkak te voneses ne percaktimin e kufijve komunal konsiderohet si pjese e komunes tjeter. Jam i vetedijshem se aty veshtire mund te intervenoni, por gjithsesi une per ate pjese do t'i drejtohem zyrtarisht edhe komunes tjeter, sepse keto pengesa (pas rikonstruksionit te rruges qe ishte ne gjendje te mjerueshme, e qe ishte aq e shumepritur nga banoret) kane shkaktuar revolte te shumica e komunitetit tek ne dhe jane krejtesisht te papranuashme edhe nga aspekti i eksperteve te kesaj lemie!

Pres nga ju reagim urgjent dhe eliminim te tyre nga rruga jone, nese nuk jane vendosur me aprovimin tuaj!

Sa me perket mua, une do te ndermarr te gjitha hapat institucional per shtjellimin e kesaj ceshtje deri ne fund!

Perndryshe, aty te ujevara (rreth pikevrojtimit) kemi edhe nje problem shume akut, hapesirat publike jane ngarkuar me materiale te ngurta, zhavor e tjera, qe i kane shkarkuar aty pronaret e shtepise perball ujevares, per te mos lejuar parkimin e automjeteve, pasi u kane "penguar"! Tani si rezultat i kesaj kemi ngushtimin e rruges dhe parkimin e automjeteve ne nje korsi te rruges, qe rrit rrezikun prej aksidenteve te renda ne komunikacion dhe shkakton bllokime here pas here kur ka komunikacion te dendur!

Me te vertete jemi pjese e skajshme e Komunes se Tuzit, por ju lutem mos na lini ne harrese, pasi ne kemi qene, jemi dhe do te jemi gjithmone pjese e Malesise!

Me respekt,
 Edmond Ujkaj